



6

## DEKLARATA E TË DREJTAVE

I dorëzohet një personi të vendosur nën arrest  
(Të mitur të moshës 16 – 18 vjeç, bashkë-autorë ose  
bashkëpunëtorë të një të rrituri që ka shkelur nenin 706-73 të kodit  
të procedurës penale)

**Informacionet e mësipërme duhet t'ju jipen në një gjuhë të cilën ju e kuptoni.**

**Ju mund të ruani këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së mbajtjes nën arrest**

Ju jeni informuar se jeni vendosur nën arrest sepse kundër jush ekzistojnë një ose më shumë arsye të besueshme për të dyshuar që keni kryer ose jeni përpjekur të kryeni, si bashkë-autorë ose bashkëpunëtorë të një të rrituri, një vepër penale të lidhur me krimin e organizuar të ndëshkueshme me burg.

Ju keni të drejtë të njihni kualifikimin, datën dhe vendin e supozuar të kryerjes së shkeljes për të cilën ju jeni akuzuar dhe arsyet justifikuese të vendosjes suaj nën arrest.

Ju do të dëgjoheni rreth këtyre fakteve gjatë mbajtjes nën arrest i cili mund të zgjasë njëzet e katër orë.

Në fund të këtij afati, prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake) do të mund të vendosë zgjatjen e mbajtjes nën arrest për një periudhë tjetër prej njëzet e katër orësh. Ju do të paraqiteni përpara këtij gjyqtari, nëse është e nevojshme me anë të një video-konference.

Përveç një rasti të jashtëzakonshëm, dhe nëse vlerësohet se ka nevojë për hetim, mund të vendosen dy zgjatje shtesë, për një periudhë kohore prej njëzet e katër orësh secila, qoftë nga gjyqtari i lirive dhe ndalimit, me kërkesë të prokurorit, qoftë nga gjyqtari i hetimeve paraprake.

Në përfundim të mbajtjes nën arrest, me urdhër të prokurorit (ose gjyqtarit të hetimeve paraprake), ju ose do të paraqiteni para këtij magjistrati, ose do të liroheni. Në rastin e parë, ju do të paraqiteni përpara një gjyqtari në rastin më të largët pas 20 orësh duke filluar nga përfundimi i mbajtjes tuaj nën arrest, me përjashtim të rastit kur mbajtja juaj nën arrest ka zgjatur më shumë se 72 orë.

### **GJITHASHTU JU INFORMOJMË SE KENI TË DREJTËN TË :**

#### **Lajmëroni disa persona të caktuar**

Një oficer ose agjent i policisë gjyqësore do të lajmërojë prindërit tuaj ose kujdestarin tuaj, ose personin apo shërbimin që kujdeset për ju lidhur me masën e arrestit kundrejt jush.

Ju gjithashtu mund të njoftoni punëdhënësin tuaj.

Nëse keni kombësi të huaj, ju gjithashtu mund të kërkonit të njoftoni autoritetet konsullore të vendit tuaj.

Prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake) megjithatë mund të kundërshtojnë këto kërkesa për arsye hetimore. Me përjashtim të rrethanave të pakapërcyeshme, këto kërkesa do të ekzekutohen pas një maksimumi prej 3 orësh duke filluar nga momenti kur keni formuluar kërkesën tuaj.

### **Kontrollim nga një mjek**

Ju mund të kërkonti të vizitoheni nga një mjek. Në rast të zgjatjes së mbajtjes nën arrest, ju mund të kërkonti të vizitoheni përsëri nga një mjek. Nëse vendoset për kohëzgjatje të reja pas dy ditësh mbajtje nën arrest, ju do të vizitoheni detyrimisht nga një mjek në çdo zgjatje të mëtejshme. Këto kërkesa mund gjithashtu të paraqiten nga prindërit tuaj, kujdestari juaj ose personi apo institucioni që kujdeset për ju.

### **Dhënie e deklaratave, përgjigja ndaj pyetjeve ose ruajtja e heshtjes**

Pasi keni deklaruar identitetin tuaj, ju keni të drejtën, gjatë marrjes suaj në pyetje :

- të jipni deklaratata,
- t'i përgjigjeni pyetjeve që ju janë drejtuar,
- ose të heshtni.

### **Asistenca nga një avokat**

#### **Zgjedhja e avokatit**

Që prej fillimit të mbajtjes nën arrest dhe, në rast të zgjatjes së mbajtjes nën arrest, që prej fillimit të kësaj zgjatjeje, ju mund të kërkonti asistencën e një avokati të zgjedhur prej jush. Nëse ju nuk jeni në gjendje të caktoni një avokat ose nëse avokati i zgjedhur nuk mund të kontaktohet, ju mund të kërkonti që një avokat t'ju caktohet automatikisht.

Avokatin tuaj mund ta caktojë gjithashtu prindërit tuaj ose kujdestari juaj, ose personi apo shërbimi që kujdeset për ju.

#### **Asistenca dhe periudha e ndërhyrjes së avokatit**

Avokati mund :

- do të takohet me ju gjatë 30 minutave në kushte që garantojnë konfidencialitetin e takimit;
- nëse ju paraqisni kërkesë, avokati juaj do të asistojë në marrjet tuaja në pyetje dhe ballafaqimet.

Në këtë rast, marrja juaje parë në pyetje, përveç rastit kur ajo përfshin vetëm elementë identiteti, nuk mund të kryhet në mungesë të avokatit tuaj përpara mbarimit të një afati kohor prej dy orësh pas njoftimit që i është bërë në lidhje me kërkesën tuaj. Sidoqoftë, marrja juaje parë në pyetje mund të fillojë menjëherë, edhe në mungesë të avokatit tuaj, me autorizim të prokurorit (ose të gjyqtarit të hetimeve paraprake), nëse kërkohet për nevoja të hetimit.

Nëse avokati juaj paraqitet gjatë një marrje në pyetje ose një konfrontimi gjyqësor, ky veprim mund të ndërpritet me kërkesën tuaj, për t'ju mundësuar të qëndroni me të.

Prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake) dhe gjyqtari i lirive dhe i ndalimit munden megjithatë, për arsye madhore dhe në kuadër përjashtimor, të vendosin për një shtyrje të asistencës nga avokati juaj gjatë marrjes në pyetje, gjatë një periudhe prej 12 orësh, me një mundësi

### **Asistenca e përkthyesit**

Nëse ju nuk e flisni apo nuk e kuptoni frëngjishten, keni të drejtën të kërkonti asistencë falas nga një përkthyes gjatë marrjes suaj në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

### **E drejta për të kërkuar përfundimin e mbajtjes nën arrest**

Ju mund t'i kërkonti prokurorit ose gjyqtarit të hetimeve paraprake ose gjyqtarit të lirive dhe ndalimit, kur ai të deklarohet për një zgjatje të mundshme të mbajtjes nën arrest, që kjo masë të mos zgjatet.

### **Qasja në disa pjesë të dosjes suaj**

Me kërkesën tuaj apo të avokatit tuaj, ju mund të kërkonti të shikoni, në rastin më të

vonë përpara një zgjatjeje të mundshme të mbajtjes nën arrest:

- procesverbalin e njoftimit të vendosjes suaj nën arrest;
- certifikatën/-at mjekësore të nxjerra nga mjeku që ju ka vizituar.
- procesverbalin/-et e marrjes tuaj në pyetje